


Regjistrimi i popullsisë 2024 në Kosovë: zbërthimi i implikimeve të ndryshimeve demografike për politikat dhe zhvillim



GUSHT, 2025

BOTUAR NGA:

INSTITUTI RIINVEST
Andrea Gropa Prishtinë 10000.
Republika e Kosovës
Tel: + 381 (0)38 244320
www.riinvestinstitute.org

Tabela e përmbajtjes

I. Përmbledhja Ekzekutive.....	1
II. Vështrim për Regjistrimit e Popullsisë 2024	3
III. Ndryshimet demografike, sistemi pensional dhe mirëqenia sociale.....	5
IV. Ndryshimet demografike dhe arsimi.....	10
V. Implikimet në shërbimet publike shëndetësore.....	15
VI. Modelet e migrimit	18
VII. Përqendrimi demografik dhe zhvillimi hapësinor	24
VIII. Shënimet përmbyllëse dhe rekomandimet e politikave	28

Lista e tabelave

Tabela 1: Niveli arsimor dhe i shkrim–leximit	11
Tabela 2: Ndryshimi në popullsinë në moshë shkollore (mosha 5–19 vjeç) në shumicën e komunave të prekura.....	13
Tabela 3: Ndryshimet në shpërndarjen e popullsisë urbane dhe rurale në Kosovë.....	19
Tabela 4: Popullsia sipas grupmoshës dhe llojit të banimit (në përqindje).....	20
Tabela 5: Modelet e migrimit të brendshëm sipas gjinisë (në përqindje)	21

Lista e figurave

Figura 1: Piramidat e popullsisë 2011 dhe 2024.....	5
Figura 2: Ndryshimet demografike në grup–moshat kryesore	6
Figura 3: Ndryshimet demografike të projektuara ndër vite.....	6
Figura 4: Raporti i varshmërisë	7
Figura 5: Indeksi i plakjes.....	7
Figura 6: Ndryshimi në strukturën e popullsisë sipas grupmoshës shkollore dhe shpërndarjes gjeografike	12
Figura 7: Komunat më të prekura nga ndryshimet demografike në ndarjen e grantit të shëndetësisë	16
Figura 8: Migrimi neto në Kosovë (2011–2024)	18
Figura 9: Komunat më të prekura nga migrimi i brendshëm sipas Regjistrimit të Popullsisë 2024	22
Figura 10: Përqendrimi demografik dhe zhvillimi hapësinor – njësitë banesore të zakonshme	25
Figura 11: Përqendrimi demografik dhe zhvillimi hapësinor – njësitë banesore të zbrazëta	26

I. Përmbledhja ekzekutive

Regjistrimi i Popullsisë 2024 përbën një arritje të rëndësishme në përpjekjet e Kosovës për të përditësuar dhe modernizuar mbledhjen e të dhënave demografike dhe socio-ekonomike, më shumë se një dekadë pas regjistrimit të vitit 2011. Ai ofron pasqyrë më të plotë dhe më të avancuar të popullsisë së Kosovës deri më sot, duke siguruar njohuri thelbësore për politikë bërjen e bazuar në të dhëna, planifikimin institucional dhe strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm.

Regjistrimi zbulon ndryshime të rëndësishme demografike. Për herë të parë në dekada, popullsia e Kosovës ka rënë, e nxitur nga nivele të larta emigrimi dhe rënie të fertilitetit. Jetëgjatësia është përmirësuar, por e kombinuar me uljen e fertilitetit po prodhon një popullsi në plakje, me pasoja në rritje të pensioneve, kujdesin shëndetësor dhe shërbimet të kujdesit afatgjatë. Dendësia e popullsisë është ulur në nivelet e regjistruara për herë të fundit në fillim të viteve 1980. Kjo rënie është e pabarabartë mes rajoneve, ku zonat rurale po përballen me zbrazje, ndërsa qendrat urbane, veçanërisht Prishtina, vazhdojnë të rriten.

Urbanizimi është intensifikuar, duke rritur kërkesën për banim, transport dhe shërbime publike në qytete, ndërkohë që zonat rurale përballen me tkurrjen e fuqisë punëtore, shkolla të pashfrytëzuara dhe infrastrukturë në rënie. Migrimi i brendshëm, sidomos tek të rinjtë, e thëllon hendekun rural-urban dhe ngre shqetësime për barazinë hapësinore (gjeografike). Kosova mbetet relativisht e re krahasuar me Evropën, por rritja e pjesëmarrjes së të moshuarve thekson urgjencën e reformave politike. Gjetjet kryesore vënë në pah sfida të cilat duhet të adresohen menjëherë. Plakja demografike do të zvogëlojë fuqinë punëtore, do të ulë konsumin dhe investimet, dhe do të rrisë presionet fiskale në sistemet sociale. Migrimi mbetet një shqetësim kritik, duke larguar talentin e ri dhe duke përkeqësuar pabarazitë rajonale. Sistemet e arsimit dhe shëndetësisë përballen me pabarazi gjeografike: shkollat urbane janë të mbingarkuara, ndërsa institucionet rurale të pashfrytëzuara; kujdesi shëndetësor urban kërkon burime të zgjeruara, ndërsa zonat e depopulluara duhet të ruajnë nivele minimale të shërbimeve. Tregu i patundshmërive pasqyron rritjen e dendësisë urbane si dhe numrin e lartë të objekteve të pabanuara, duke kërkuar planifikim më të fortë urban dhe politika të balancuara zhvillimore.

Të dhënat e Regjistrimit nxjerrin qartë në pah disa prioritetet kyçe të politikave. Rekomandimet përfshijnë:

- Rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës përmes kujdesit për fëmijë, pushimeve prindërore, punës fleksibile dhe mbështetjes për ndërmarrësi.
- Zhvillimin e sistemeve afatgjata të kujdesit të bazuara në komunitet dhe forcimin e fuqisë punëtore në sektorin e kujdesit.
- Koordinimin e investimeve në arsim me trendet demografike, veçanërisht në komunat me rritje të shpejtë, duke lidhur politikat arsimore me zhvillimin ekonomik lokal.
- Fillimin e një reforme të gjithanshme të pensioneve duke e përafruar moshën e pensionimit me pritshmërinë e jetesës.
- Promovimin e të nxënit gjatë gjithë jetës dhe “ekonomisë së argjendtë” për të shfrytëzuar mundësitë që sjell jetëgjatësia më e lartë.
- Nxitjen e rritjes së balancuar rajonale përmes investimeve drejt ekonomive rurale, aftësimin e të rinjve dhe angazhimin e diasporës.
- Forcimin e planifikimit urban, politikave të banimit të përbalueshëm dhe menaxhimit të transportit për të siguruar rritje të qëndrueshme të qyteteve.

Regjistrimi i Popullsisë 2024 paraqet një thirrje vendimtare për institucionet e Kosovës që të përshtaten me realitetet e reja demografike. Politikat proaktive dhe të synuara, të mbështetura në të dhëna të besueshme, do të jenë thelbësore për ruajtjen e rritjes, forcimin e kohezionit social dhe garantimin e zhvillimit të barabartë në të gjithë Kosovën.

II. Vështrim për regjistrimin e popullsisë 2024

Regjistrimi i Popullsisë në vitin 2024 shënon një moment kyç për Kosovën në përditësimin e të dhënave demografike dhe socio-ekonomike, më shumë se një dekadë pas regjistrimit të fundit të kryer në vitin 2011. Si procesi më i gjerë dhe metodologjikisht më i avancuar i grumbullimit të dhënave në vend deri më sot, Regjistrimi i vitit 2024 ofron një pamje të re dhe shumë më të detajuar të strukturës së popullsisë, kushteve të jetesës, shpërndarjes hapësinore dhe trendeve të migrimit të brendshëm. Këto të dhëna janë thelbësore për hartimin e politikave të bazuara në evidencë, përmirësimin e planifikimit institucional dhe harmonizimin e strategjive kombëtare me nevojat reale të komuniteteve në tërë Kosovën. Regjistrimi nxjerr në pah një sërë ndryshimesh të rëndësishme demografike krahasuar me vitin bazë 2011. Mbase ndër më të rëndësishmet është fakti se Kosova ka pësuar një rënie të lehtë, por domethënëse të numrit të përgjithshëm të popullsisë. Ky zhvillim shënon një pikë kthese pas dekadave me rritje të qëndrueshme të popullsisë dhe vjen kryesisht si rezultat i dy trendeve paralele: niveleve të larta të emigrimit dhe rënies së shkallës të fertilitetit. Përmirësimet në cilësinë e jetës dhe ulja e mortalitetit kanë rritur pritshmërinë mesatare të jetës, e cila së bashku me rënien e fertilitetit po çon gradualisht në plakjen e popullsisë. Dendësia mesatare e popullsisë ka rënë nga 163 banorë për kilometër katror në vitin 2011 në 147 në vitin 2024, duke u kthyer në nivelet e regjistruara në fillim të viteve '80. Kjo rënie nuk është e shpërndarë njëtrajtësisht ndër rajone, çka thekson edhe më tej pabarazitë e brendshme gjeografike.

Sipas të dhënave të Regjistrimit të vitit 2024, urbanizimi ka vazhduar të intensifikohet si në shtrirje ashtu edhe në përmasa. Qytetet e mëdha, veçanërisht Prishtina dhe zona periferike përreth saj, kanë shënuar rritje të vazhdueshme të popullsisë, ndërsa shumë komuna rurale dhe zona të largëta po përballen me tkurrje të thellë demografike. Këto zona rurale gjithnjë e më tepër po përballen me mbyllje shkollash, mungesë të fuqisë punëtore dhe kapacitete infrastrukturore të pashfrytëzuara. Kjo tendencë shton shqetësimet për barazinë hapësinore dhe qëndrueshmërinë e ofrimit të shërbimeve publike jashtë zonave urbane. Rritja e migrimit të brendshëm, sidomos në mesin e të rinjve që kërkojnë mundësi më të mira arsimimi dhe punësimi, ka thelluar ndarjen midis zonave urbane dhe rurale, duke vënë në pah nevojën për politika të zhvillimit rajonal më të balancuara. Regjistrimi po ashtu ofron një kuptim më të thelluar të strukturës demografike të vendit. Edhe pse popullsia e Kosovës vazhdon të mbetet relativisht e re krahasuar me vendet e tjera evropiane, të dhënat e vitit 2024 tregojnë rritje të ndjeshme të përqindjes së moshës së tretë. Kjo tendencë pritet të përshpejtohet në dekadat e ardhshme, duke rritur presionin mbi sistemin pensional dhe kërkesën për shërbime afatgjata të kujdesit social e shëndetësor. Çekuilibri i moshave paraqet sfida të rëndësishme sociale dhe ekonomike dhe kërkon ndërhyrje të hershme politike, përfshirë reformimin e pensioneve, nxitjen e plakjes aktive dhe zgjerimin e infrastrukturës së kujdesit shëndetësor për të moshuarit.


Përtej aspektit demografik, Regjistrimi i vitit 2024 është mbështetur në qasje metodologjike të përmirësuar dhe në përdorimin e mjeteve digjitale, të cilat rritën cilësinë e të dhënave. Për herë të parë, mbledhja e të dhënave u realizua gjerësisht përmes mjeteve elektronike, duke rritur saktësinë dhe efikasitetin e procesit.

Rezultatet e Regjistrimit të vitit 2024 theksojnë nevojën që institucionet e Kosovës të harmonizojnë prioritetet politike me realitetet e reja demografike. Investimet e fokusuara në arsim, shëndetësi, planifikim urban dhe aktivizim të tregut të punës, veçanërisht për gratë dhe të rinjtë, do të jenë vendimtare për të siguruar rritje të qëndrueshme ekonomike dhe kohezion social në vitet që vijnë.

III. Ndryshimet demografike, sistemi pensional dhe mirëqenia sociale

Kosova historikisht është karakterizuar nga një popullsi e re, me 45% të popullsisë nën moshën 30 vjeçare në vitin 2024. Megjithatë, ndryshimet demografike janë të dukshme krahasuar me regjistrimin e vitit 2011, në të cilin 55% e popullsisë i përkisnin kësaj grup moshe. Piramidat e popullsisë së Kosovës tregojnë një zhvendosje nga një strukturë e gjerë në bazë, me shumë fëmijë dhe të rinj, drejt një shpërndarje më të balancuar, të karakterizuar nga një pjesëmarrje më e vogël e të rinjve dhe një përqindje relativisht më e madhe e të rriturve, që tregon norma më të ulëta të lindshmërisë dhe plakje graduale të popullsisë (Figura 1). Mesazhi nga të dhënat e regjistrimit të popullsisë 2024 është i qartë, përparësitë demografike të Kosovës po ngushtohet.


Figura 1: Piramidat e popullsisë 2011 dhe 2024



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Në vitin 2011, rreth 7 përqind e popullsisë ishte 65 vjeç e më shumë, ndërsa në vitin 2024 kjo shifër u rrit në 11 përqind. Kjo zhvendosje demografike paraqitet në Figurën 2, ku pjesëmarrja e fëmijëve (0–14) në popullsinë totale ra nga 28 përqind sa ishte në vitin 2011, në 21.8 përqind më 2024; popullsia në moshë pune (15–64) u rrit nga 65.3 përqind në 67.1 përqind; ndërsa popullsia mbi moshën 65 vjeç u rrit nga 6.7 përqind në 11.1 përqind. Mirëpo, në shifra absolute, pjesëmarrja e fëmijëve (0–14) dhe e popullsisë në moshë pune (15–64) u zvogëlua mes këtyre dy periudhave kohore.

Figura 2: Ndryshimet demografike në grup-moshat kryesore




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Përderisa përqindja e të moshuarve është duke u rritur, përqindja e popullsisë në moshë pune pritet të ulet gradualisht në më pak se 60 përqind deri në vitin 2061, dhe përqindja e fëmijëve në popullsinë totale do të zbres në më pak se 20 përqind (Figura 3). Projektionet janë bërë duke përdorur variantin mesatar të Agjencisë së Statistikave të Kosovës.¹ Ky skenar sugjeron se në të ardhmen Kosova do të ketë më shumë të moshuar sesa fëmijë, duke ngritur pyetje rreth

6

qëndrueshmërisë së sistemit aktual pensional.

Figura 3: Ndryshimet demografike të projektuara ndër vite




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

¹ Në dy skenare alternative, njëri pesimist (i ulët) dhe tjetri optimist (i lartë), deri në vitin 2061, përqindja e popullsisë 0-14 vjeç projektohet të jetë 8% dhe 13% respektivisht; përderisa përqindja e popullsisë mbi moshën 65 vjeç do të arrijë në 41% dhe 27% respektivisht. Popullsia në moshë pune (15-64) parashihet të jetë mes 51% dhe 60% në tri skenaret.


Për të vlerësuar barrën financiare që të varurit (fëmijët dhe të moshuarit) i vendosin popullsisë në moshë pune, llogariten raporti i varësisë së moshës së vjetër dhe raporti i përgjithshëm i varësisë (Figura 4).² Raporti i përgjithshëm i varësisë në Kosovë ka rënë nga 53 sa ishte në 2011, në 49 në vitin 2024. Mirëpo, raporti i varësisë së moshës së vjetër u rrit nga 11 sa ishte në vitin 2011, në 17 në vitin 2024. Kjo sugjeron se tashmë për çdo 100 individë në moshë pune, kemi 17 persona të moshuar, krahasuar me 11 sa ishin në vitin 2011. Raporti i varshmërisë është një indikator kyç që reflekton implikimet ekonomike si pasojë e trendeve demografike, të cilat kryesisht janë ndikuar nga rënia e shkallës së lindjeve dhe rritja e pritshmërisë së jetës. Rënia e normave të fertilitetit paraqet sfida për tregun e punës dhe rritjen ekonomike, pasi një popullsi në tkurrje në moshë pune duhet të mbështesë një popullsi të moshuar në rritje. Në të njëjtën kohë, rritja e jetëgjatësisë së pritshme vendos presione fiskale në shërbimet publike.³ Këto implikime maten edhe me një tregues përmbledhës të quajtur indeksi i plakjes, i cili tregon raportin e personave mbi 65 vjeç për çdo 100 fëmijë (0–14). Raporti i plakjes u rrit nga gati 24 që ishte në 2011, në 51 në vitin 2024 (Figura 5). Shprehur në terma praktikë, nëse para më shumë se një dekade për çdo 100 fëmijë ishin 24 të moshuar, tashmë janë 51 të moshuar për çdo 100 fëmijë.

Figura 4: Raporti i varshmërisë



Burimi: Kalkulimet e autorit

Figura 5: Indeksi i plakjes



Burimi: Kalkulimet e autorit

Meqenëse kapitali njerëzor është shtytës kyç i zhvillimit ekonomik, plakja e popullsisë bart implikime të rëndësishme. Ajo jo vetëm sinjalizon ngushtimin e dritares së avantazhit

² Raporti i përgjithshëm i varësisë mat numrin e varësve, duke krahasuar popullësinë në grupmoshën 0–14 dhe ata mbi 65 vjeç, krahas popullësisë në moshë pune (15–64). Për dallim nga kjo, raporti i varësisë së moshës së vjetër, krahason vetëm popullësinë mbi moshën 65 vjeç krahas popullësisë në moshë pune (16–64).

³ Harper, S (2014). Economic and social implications of ageing societies. (PDF) [Economic and social implications of ageing societies](#)

demografik, por edhe rritjen e presioneve fiskale dhe të politikave sociale, veçanërisht në sistemet pensionale, mbrojtjen sociale, dhe kujdesin afatgjatë. Rritja e popullsisë mbi moshën 65 vjeç, e kombinuar me uljen e hyrjeve të të rinjve, nënkupton më pak kontribuues në raport me të pensionuarit, sidomos kur emigrimi ndikon në mënyrë jo-proporcionale në popullsinë në moshë pune.

Me rritjen e raportit të varësisë së të moshuarve me rreth 60 përqind që nga viti 2011 dhe me projeksionet që tregojnë rritje të mëtejshme, bëhen të domosdoshme reforma parametrike në pensione. Për të ruajtur besimin publik, tre hapa mund të ndërmerren dhe të shpallen me kohë të përshtatshme. Së pari, mosha e pensionimit të harmonizohet gradualisht me jetëgjatësisë e pritshme. Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti kërkon që mosha e pensionimit të rishikohet të paktën çdo pesë vjet;⁴ megjithatë, kjo nuk ka ndodhur ende. Duke supozuar se të dhënat e besueshme mbi jetëgjatësisë e pritshme së personave në pensionim janë në dispozicion, rishikimi duhet të kryhet duke lidhur moshën e pensionimit me jetëgjatësisë e pritshme. FMN (2024) rekomandon, si një opsion, rritjen e moshës së pensionimit me dy të tretat e rritjes së jetëgjatësisë së pritshme në moshën 65 vjeç, duke ruajtur kështu një raport të qëndrueshëm midis viteve të punës dhe viteve në pension.⁵ Së dyti, duke pasur parasysh diasporën e Kosovës dhe modelet e mobilitetit, transferueshmëria është e rëndësishme. Prandaj, duhet të njihet historiku i kontributeve përtej kufijve dhe të krijohen kanale me pak pengesa për punëtorët e diasporës që të kontribuojnë në llogaritë pensionale të Kosovës; skemat komplementare, profesionale ose vullnetare të shtyllës së dytë, me fonde të ciklit të jetës dhe tarifa të ulëta, mund të krijojnë rezerva që ulin presionet e ardhshme mbi përfitimet e financuara nga taksat. Së fundi, duhet ruajtur përshtatshmëria e synuar. Me rritjen e popullsisë së moshuar, rritet edhe rreziku i varfërisë në moshë të thyer, sidomos për gratë dhe punëtorët me karriera të fragmentuara. Një pension minimal që është modest, por i indeksuar, mund të parandalojë varfërinë, ndërsa përfitimet shtesë duhet të përqendrohen tek të moshuarit me të ardhura më të ulëta për të shmangur zgjerime të përgjithshme të paqëndrueshme.

Demografia nuk ndikon vetëm pensionet, por edhe kërkesën për kujdes. Ndryshimi i raporteve në Figurën 3 sugjeron se në vitet 2040, të rriturit e moshuar do të jenë grupi kryesor i të varurve. Kujdesi afatgjatë është i kushtueshëm kur mbështetet tek institucionet; është më i qëndrueshëm dhe më në përputhje me preferencat kur ofrohet afër shtëpisë. Kosova duhet të vendosë themelet për një model të kujdesit afatgjatë të orientuar nga komuniteti. Meqenëse familja mbetet ofruesi kryesor i kujdesit, roli i shtetit është të plotësojë dhe profesionalizojë, e jo të zëvendësojë atë. Pagesat e vogla për kujdestarët, të lidhura me trajnime dhe opsione pushimi,

⁴ Article 17 of [The Law No. 04/L-131 on Pension Schemes Financed by the State](#)

⁵ International Monetary Fund (IMF) Country Reports 24/365, 2024. [The Challenges of the Pension Reform in Kosovo](#).

mund të parandalojnë djegien emocionale dhe të vonojnë institucionalizimin e kushtueshëm. Paralelisht, fuqia punëtore e kujdesit duhet rritur si dhe duhet integruar kompetencat geriatrike në kurrikulat e infermierisë. Financimi duhet të jetë i kujdesshëm. Në vend se të nisë një të drejtë pa kufizime, Kosova mund të zbatojë gradualisht një përfitim të testuar për gjendjen ekonomike për të moshuarit me nevoja të larta dhe të ardhura të ulëta.

Financat publike mund të mbeten të qëndrueshme edhe me ndryshimet demografike nëse pjesëmarrja dhe produktiviteti rriten. Rënia e pritshme e përqindjes së popullsisë në moshë pune në dekadat e ardhshme mund të zbutet duke rritur pjesëmarrjen në tregun e punës, veçanërisht në mesin e grave, përmes kujdesit të përballueshëm për fëmijët, orareve fleksibile në sektorin publik dhe njohjen e kontributeve nga periudhat e kujdesit pa e reduktuar të drejtën për pension në jetëgjatësi. Po aq e rëndësishme është rritja e produktivitetit, me drejtimet të forta profesionale dhe përhapjen e teknologjive digjitale dhe të gjelbra në sektorin privat. Me më pak të rinj që hyjnë në tregun e punës, rritja do të duhet të mbështetet në thellimin e kapitalit njerëzor dhe rritjen e intensitetit të kapitalit.

IV. Ndryshimet demografike dhe arsimi

Derisa Kosova po kalon një periudhë të tranzicionit social dhe ekonomik, trendet demografike nga të dhënat e fundit të regjistrimit të popullsisë ofrojnë njohuri qenësore për përcaktimin e prioriteteve të politikave të ardhshme. Një krahasim në mes të dhënave të regjistrimit të popullsisë të vitit 2024 dhe 2011 të Kosovës tregon ndryshime demografike që janë veçanërisht të dukshme në strukturën dhe madhësinë e popullsisë së të rinjve. Këto ndryshime kanë implikime të drejtpërdrejta për sektorin e arsimit, i cili mbetet një shtyllë kritike e zhvillimit afatgjatë të Kosovës. Në këtë kontekst, reagimi ndaj ndryshimeve demografike kërkon një qasje gjithëpërfshirëse dhe sistematike ndaj reformës arsimore, një qasje që bazohet në prova, që i përgjigjet nevojave në zhvillim dhe e përshtatur me realitetet zhvillimore sociale dhe rajonale të Kosovës.

Arritjet arsimore njihen gjerësisht si një nxitës kryesor i formimit të kapitalit njerëzor dhe zhvillimit afatgjatë, dhe trendet e identifikuar nga regjistrimi i fundit i popullsisë ilustrojnë përparim të rëndësishëm në këtë drejtim. Mes viteve 2011 dhe 2024, Kosova ka arritur përmirësime të dukshme në arsim në të gjithë popullsinë e saj (Tabela 1). Numri i individëve me arsim të lartë të përfunduar është dyfishuar, duke u rritur nga 116,912 në 233,559. Në terma relativë, përqindja e popullsisë së moshës mbi 10 vjeç të cilët kanë përfunduar arsimin e lartë është rritur nga rreth 8% në 17%. ⁶Pjesa e popullsisë që ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë është rritur gjithashtu, ndërsa ata me vetëm arsim të mesëm të ulët ose fillor kanë rënë. Me rëndësi të veçantë është rënia e numrit të individëve analfabetë, duke treguar një qasje më të gjerë në shkrim–lexim dhe arsim bazë.

⁶Eurostat raporton përqindjen e popullsisë së moshës 10 vjeç e lart me arsim të përfunduar, sepse ky prag moshe kap pjesën e popullsisë që zakonisht ka pasur mundësinë të përfundojë të paktën arsimin bazë. Raportimi sipas moshës 10+ siguron që fëmijët shumë të vegjël, të cilët janë ende në procesin e fillimit të shkollës, të përjashtohen, duke ofruar një masë më të saktë të arritjeve arsimore në popullsi.


Tabela 1: Niveli arsimor dhe i shkrim–leximit

Treguesit kryesorë të arsimit	2011	2024	Ndryshimi
Popullsia me arsim të lartë të përfunduar	116,912	233,559	↑
Përqindja e popullsisë së moshës 10 vjeç e lart me arsim të lartë të përfunduar	8.18%	17.17%	↑
Popullsia me arsim të mesëm të përfunduar	427,905	475,809	↑
Përqindja e popullsisë me arsim të mesëm të lartë në popullsinë e moshës mbi 10 vjeç	29.94%	34.97%	↑
Popullsia me arsim të mesëm të ulët të përfunduar	501,617	389,030	↓
Përqindja e popullsisë me arsim të mesëm të ulët në popullsinë e moshës 10 vjeç e lart	35.10%	28.59%	↓
Popullsia me arsim fillor të përfunduar	245,552	186,020	↓
Përqindja e popullsisë me arsim fillor në popullsinë e moshës 10 vjeç e lart	17.18%	13.67%	↓
Popullsia pa arsim formal / pa përfunduar asnjë nivel arsimi, por e shkolluar	82,188	24,408	↓
Përqindja e popullsisë pa arsim formal / nuk e ka përfunduar nivelin e arsimit për aftësitë e leximit dhe shkrimit	5.75%	1.79%	↓
Numri total i popullsisë analfabete	55,001	30,902	↓
Përqindja e individëve analfabetë në popullsinë e moshës 10 vjeç e lart	3.85%	2.27%	↓

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Ndërkohë që niveli arsimor është përmirësuar, është e rëndësishme gjithashtu të merret në konsideratë dinamika demografike që formëson kërkesën e ardhshme për arsim. Popullsia në moshë shkollore (5–19 vjeç) ka pësuar ndryshime të dukshme si në zonat rurale ashtu edhe në ato urbane. Në zonat urbane, popullsia e moshës 5–9 vjeç është rritur vetëm me 3.9 përqind, ndërsa grupmoshat 10–14 dhe 15–19 vjeç kanë regjistruar rënie modeste prej 4.6 përqind dhe 7.6 përqind, përkatësisht. Kjo sugjeron që popullsia në moshë shkollore në qytete ka mbetur relativisht e qëndrueshme, duke ushtruar presion të limituar mbi shkollat urbane. Në anën tjetër, zonat rurale kanë parë një tkurrje të ndjeshme në të gjitha grupmoshat, ku popullsia 5–19 vjeç që ka rënë me më shumë se 40 përqind, duke përfshirë ulje prej mbi 44 përqind në grupet 10–14 dhe 15–19 vjeç (Figura 6). Këto rënie të mëdha tregojnë një zhvendosje të madhe demografike larg vendbanimeve rurale.

Figura 6: Ndryshimi në strukturën e popullsisë sipas grupmoshës shkollare dhe shpërndarjes gjeografike



Ndryshimet demografike në popullsinë e moshë shkollare janë gjithashtu të dukshme në nivel komunal. Tabela më poshtë nxjerr në pah pesë komuna që përjetuan ndryshimet më të theksuara midis viteve 2011 dhe 2024. Fushë Kosova (55%) dhe Graçanica (54%) regjistruan rritje të lartë në popullsinë e tyre në moshë shkollare, ndërsa komunat më të mëdha si Gjilani (-36%), Gjakova (-41%) dhe Prizreni (-36%) patën rënie të ndjeshme. Këto modele sugjerojnë që komunat më afër kryeqytetit ose që ofrojnë mundësi më të mira ekonomike po tërheqin më shumë banorë, ndërsa të tjerat kanë një shpopullim të konsiderueshëm. Në disa komuna, shumë shkolla tani kanë shumë pak nxënës për klasë, dhe në disa raste, të gjitha nivelet kanë regjistrim minimal. Disa objekte shkollare mund të funksionojnë me një pjesë mjaft të vogël të kapacitetit të tyre, ndërsa të tjerat mund të jenë mbyllur ose bashkuar në heshtje. Këto trende ngrenë shqetësime në lidhje me cilësinë e arsimit në zonat e shpopuluara, efikasitetin e kostos së mirëmbajtjes së infrastrukturës së nënshfrytëzuar dhe ndikimin më të gjerë shoqëror tek fëmijët.

Tabela 2: Ndryshimi në popullsinë në moshë shkollore (mosha 5–19 vjeç) në shumicën e komunave të prekura⁷

Komuna	2011	2024	Ndryshimi
Fushë Kosovë	9,882	15,307	5,425
Graçanicë	2,570	3,952	1,382
Gjilan	26,879	17,075	-9,804
Gjakovë	28,620	16,865	-11,755
Prizren	51,893	32,995	-18,898

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Këto ndryshime demografike dhe arsimore kanë implikime të rëndësishme politike për Kosovën. Nga njëra anë, rritja e vazhdueshme e arritjeve arsimore forcon kapitalin njerëzor të vendit, duke e pozicionuar atë për një konkurrueshmëri më të madhe ekonomike dhe zhvillim afatgjatë. Megjithatë, shpërndarja e pabarabartë e popullsisë në moshë shkollore, e mbështetur nga stabiliteti ose rritja në komunat urbane dhe rënie të ndjeshme në shumë komuna rurale, krijon sfida për sistemin arsimor. Shkollat me regjistrim të ulët në zonat rurale jo vetëm që rrezikojnë joefikasitet dhe kosto më të larta për nxënës, por gjithashtu ngritin shqetësime për cilësinë e arsimit, qasjen e barabartë dhe mirëqenien shoqërore të fëmijëve në komunitete. Në të njëjtën kohë, shkollat urbane mund të përballen me kërkesë në rritje në disa komuna, duke kërkuar përshtatje në infrastrukturë, personel dhe ndarjen e burimeve.

Çekuilibri në rritje midis zonave rurale në tkurrje dhe qendrave urbane në zgjerim kërkon një rimendim të planifikimit shkollor, politikave të çarta arsimore dhe strategjive afatgjata të investimeve. Në komunat që përjetojnë një shpopullim të rëndë, politikëbërësit duhet të marrin në konsideratë konsolidimin e shkollave të nënshfrytëzuara, duke siguruar që nxënësit të mund të vazhdojnë të kenë qasje në arsim në mënyrë të sigurt dhe të përshtatshme përmes investimeve në transportin shkollor dhe rrjeteve shkollore të optimizuara. Kjo qasje do të ndihmonte në ruajtjen e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së arsimit në zonat me rënie të regjistrimit, duke ulur njëkohësisht koston e mirëmbajtjes së infrastrukturës së nënshfrytëzuar.

Në qendrat urbane me rritje të shpejtë, veçanërisht përreth Prishtinës, zgjerimi strategjik i kapacitetit arsimor është thelbësor. Qeveritë lokale duhet të përshpejtojnë investimet në shkolla të reja, klasa shtesë dhe rekrutimin e stafit të kualifikuar për të përmbushur kërkesën në rritje.

⁷Tabela tregon tre komunat më të prekura nga rritjet dhe uljet e popullsisë në moshë shkollore.

Zvogëlimi i madhësisë së klasave dhe modernizimi i objekteve duhet të jenë gjithashtu përparësi për të ruajtur standarde të larta të cilësisë arsimore dhe për të promovuar barazinë midis nxënësve, veçanërisht pasi shkollat urbane përballen me presion nga rritja e regjistrimeve.

Përtej përmirësimeve të infrastrukturës, politikat arsimore duhet të lidhen me strategji më të gjera të zhvillimit rajonal. Nxitja e mundësive ekonomike në komunat në shpopullim, përmes mbështetjes për bizneset lokale dhe programeve të krijimit të vendeve të punës, mund të ndihmojë në ngadalësimin e migrimit jashtë vendit dhe në mbajtjen e familjeve të reja, duke kontribuar në trende demografike më të balancuara. Forcimi i koordinimit midis planifikimit të arsimit, monitorimit demografik dhe politikave ekonomike lokale do të jetë kritik për të siguruar që sistemi arsimor të mbetet efikas, elastik dhe i barabartë. Duke përafruar investimet, planifikimin e rrjetit shkollor dhe përpjekjet për zhvillim rajonal, Kosova mund të krijojë një sistem arsimor që në mënyrë dinamike përshtatet me ndryshimet e popullsisë, duke ofruar njëkohësisht arsim me cilësi të lartë dhe të arritshëm për të gjithë fëmijët, pavarësisht vendndodhjes.

V. Implikimet në shërbimet publike shëndetësore

Rënia e shkallës së lindjeve në Kosovë lidhet ngushtë me zvogëlimin e popullsisë në grupmoshën riprodhuese (15–49 vjeç), e cila ka rënë më shumë se 16 përqind në nivel vendi. Ky trend është i ndërlidhur drejtpërdrejt me emigrimin e të rinjve dhe familjeve që kërkojnë kushte më të mira jetese dhe punësimi jashtë vendit. Përveç kësaj, ndryshimet në stilin e jetesës, urbanizimi dhe zgjedhjet bashkëkohore familjare, si preferenca për familje më të vogla dhe investimi më i madh në rritjen dhe mirëqenien e fëmijëve, kanë ndikuar gjithashtu në uljen e numrit të lindjeve. Mes tjerash, tendenca për shtyrjen e martesës dhe lindjes në moshë më të vonshme ka reduktuar lindjet në periudhën afatshkurtër. Ndikim të veçantë ka pasur edhe migrimi i brendshëm, i cili ka shkaktuar ulje të ndjeshme të popullsisë në disa komuna. Këto lëvizje demografike nuk janë thjesht të dhëna statistikore por ato kanë pasoja të drejtpërdrejta për politikat publike, sidomos në sektorin e shëndetësisë.


Sipas Ligjit për Shëndetësinë Nr. 04/L-125 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2020, Kujdesi Parësor Shëndetësor në Kosovë ofrohet përmes Qendrave të Mjekësisë Familjare dhe Ambulancave. Numri i personelit në këto njësi përcaktohet sipas standardeve ligjore, në raport të drejtpërdrejtë me numrin e banorëve që ato mbulojnë. Çdo Qendër e Mjekësisë Familjare duhet të mbulojë së paku 10 mijë banorë, ndërsa një ekip i përbërë nga një mjek familjar dhe dy infermierë duhet të mbulojë të paktën 2 mijë banorë. Me regjistrimin e vitit 2024, këto llogaritje pritet të ndryshojnë ndjeshëm. Në nivel vendi, numri i mjekëve familjarë të nevojshëm pritet të ulet nga 909 në 801 – një reduktim prej 109 mjekësh. Po ashtu, numri i infermierëve bie nga 1,818 në 1,602, ndërsa ai i dentistëve nga 374 në 320. Këto ndryshime shpjegojnë më së miri se si lëvizjet demografike ndikojnë drejtpërdrejt në kapacitetin e shërbimeve shëndetësore, duke kërkuar rishikim të vazhdueshëm të politikave dhe planifikimit të burimeve.

Mes tjerash, këto zhvillime kanë edhe pasoja të qarta buxhetore. Në buxhetin e vitit 2025 janë paraparë 81.8 milionë euro për grantin e shëndetësisë, të ndara në përputhje me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve dhe Qarkoren Buxhetore 2025/01, ku ende merret si bazë regjistrimit të vitit 2011. Përdorimi i regjistrimit të vitit 2024 si pikë reference do ta rrisë ndarjen (alokimin) për kokë banori nga 47 në 51 euro. Në nivel komunal, ky rikalibrim prodhon efekte të ndryshme: 25 komuna do të përfitonin rritje të grantit për kokë banori, ndërsa tetë komuna do të përballeshin me ulje.

Figura (7) më poshtë paraqet dhjetë komunat më të prekura nga këto lëvizje demografike, duke evidentuar pesë komunat me rritjen më të madhe të popullsisë dhe pesë komunat me rënien më të theksuar. Komunat që kanë përjetuar rënie të popullsisë, si Ranillugu, Juniku, Novobërda, Deçani dhe Rahoveci, përfitojnë më shumë grant për kokë banori, pasi buxheti ekzistues i shëndetësisë tani shpërndahet për një numër më të vogël banorësh. Në të kundërtën, komunat

me rritje të popullsisë, si Fushë Kosova, Parteshi, Graçanica, Shtërpca dhe Kllokoti, përballen me nivel më të vogël të grantit për kokë banori, meqenëse buxheti i njëjtë fiksohet për një numër më të madh banorësh.

Figura 7: Komunat më të prekura nga ndryshimet demografike në ndarjen e grantit të shëndetësisë



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Në tërësi, këto ndryshime nxjerrin në pah domosdoshmërinë e përditësimit të ndarjes së burimeve publike në përputhje me realitetet aktuale demografike. Përdorimi i të dhënave të regjistrimit të vitit 2024 siguron një shpërndarje më të drejtë dhe më të barabartë të fondeve për shëndetësi, duke reflektuar nevojat reale të popullsisë dhe duke mundësuar planifikim më të saktë të shërbimeve shëndetësore në gjithë Kosovën.

Për t'i adresuar këto implikime, mund të ndërmerren një sërë masash politike që synojnë tranzicione më të lehta, garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve dhe barazi në ndarjen e resurseve. Para së gjithash, duhet të krijohet një kornizë dinamike për shpërndarjen e fuqisë punëtore në sektorin e shëndetësisë, duke e lidhur numrin e stafit me të dhënat demografike dhe të popullsisë, që përditësohen rregullisht, si dhe duke përcaktuar një prag minimal të shërbimeve për të gjitha komunat, pavarësisht rënies së popullsisë. Po ashtu, duhet të krijohen mekanizma që mundësojnë zhvendosjen e stafit shëndetësor nga komunat ku nevoja për personel është ulur, drejt komunave që po përballen me rritje të popullsisë dhe kërkesë më të madhe për shërbime. Në raste të tjera, komunat mund të ndajnë të njëjtët profesionistë ose shërbime (p.sh. një ekip që mbulon dy ose më shumë komuna), në mënyrë që edhe zonat me

rënie të popullsisë të ruajnë mbulimin minimal të nevojshëm, ndërsa zonat në rritje të marrin mbështetje shtesë pa vonesa.


Kjo qasje do të siguronte një balancë më të mirë ndërmjet efikasitetit, qasjes së barabartë dhe vazhdimësisë së shërbimeve. Paralelisht, mund të zbatohet një mekanizëm rregullimi gradual, duke kufizuar ndryshimet vjetore në grantin për kokë banori (p.sh., $\pm 10-15\%$) dhe duke e zbatuar rikalibrimin e plotë brenda dy deri në tre cikleve buxhetore, në mënyrë që të shmangen ndërprerjet e menjëhershme të shërbimeve. Stabilizimi i përkohshëm përmes fondeve shtesë (fonde top-up) do të mund të mbështeste komunat që përballen me rënie të theksuar të popullsisë (mbi 30-40%), me kusht që ato të hartojnë një plan të qartë për vazhdimësinë e shërbimeve.

Po ashtu, matja e popullsisë mund të harmonizohet duke përdorur mesatare lëvizëse nga regjistrat administrative së bashku me të dhënat e regjistrimit të vitit 2024, ose përmes një sistemi të vlerësimeve kalimtare (p.sh., 50/50 në vitin e parë), me qëllim të zbutjes së ndryshimeve të menjëhershme në bazën llogaritëse. Për komunat më të vogla që kanë pësuar rënie të konsiderueshme, mekanizmat e bashkëpunimit ndërkomunal, si prokurimet e përbashkëta ose rrjetet rajonale të kujdesit parësor, mund të ndihmojnë në ruajtjen e efikasitetit dhe sigurimin e shërbimeve. Në fund, forcimi i qeverisjes së të dhënave përmes auditimeve të pavarura të popullsisë dhe saktësisë së regjistrave, së bashku me një proces formal ankese para finalizimit të ndarjes së granteve, do të rriste transparencën, saktësinë dhe besimin në sistemin e alokimit të fondeve.

VI. Modelet e migrimit

Migrimi ka luajtur një rol të rëndësishëm në formësimin e zhvillimit socio-ekonomik të Kosovës, veçanërisht gjatë dy dekadave të fundit. Derisa globalizimi ka përshpejtuar transformimet shoqërore dhe ka zhvendosur modelet e migrimit nga lëvizjet kolektive drejt atyre individuale, të udhëhequra kryesisht nga dallimet e mundësive ndërmjet vendeve, migrimi në Kosovë vazhdon të nxitet fuqishëm nga nivelet e larta të papunësisë, varfërisë dhe dëshira për arsimim më cilësor.⁸

Figura 8: Migrimi neto në Kosovë (2011–2024)



Burimi: Eurostat (2024)

Regjistrimi i vitit 2024 tregon se popullsia e Kosovës ka rënë me 8.8% krahasuar me vitin 2011. Kjo prirje konfirmohet edhe nga të dhënat e migrimit neto. Në vitin 2011, Kosova regjistroi një migrim neto negativ prej 9,064 personash; deri në vitin 2015 ky numër u rrit gjashtëfish, ndërsa në vitin 2024 ai ishte më shumë se i dyfishuar krahasuar me vitin 2011 (figura 8). Ky intensifikim i migrimit pasqyron rritjen e pakënaqësisë me kushtet ekonomike e sociale brenda vendit dhe dëshirën gjithnjë e më të theksuar – veçanërisht tek të rinjtë, për të kërkuar mundësi më të mira jashtë Kosovës.

⁸ MPB (Ministria e Punëve të Brendshme), Profili i Migracionit 2023, 2024, Prishtina: Ministria e Punëve të Brendshme.

Destinacionet kryesore të migrimit për qytetarët e Kosovës mbeten Gjermania dhe vendet e tjera gjermanofolëse, të cilat tërheqin migrantë kryesisht për shkak të mungesës së fuqisë punëtore dhe procedurave të lehtësuara të imigrimit. Sllovenia dhe Kroacia renditen gjithashtu lart si destinacione për migrim për punësim, ndërsa Italia, Finlanda dhe Franca shfaqen më së shumti si destinacione për bashkim familjar.⁹ Dinamika që e udhëheq migrimin ndërkombëtar ndikon dukshëm edhe në migrimin e brendshëm në Kosovë. Urbanizimi i shpejtë gjatë dekadës së fundit– ku, për herë të parë, më shumë se gjysma e popullsisë jeton në zona urbane– është tregues i qartë i migrimit të brendshëm të nxitur nga pabarazitë strukturore ndërmjet zonave urbane dhe rurale (tabela 3). Kjo prirje mund të shpjegohet edhe përmes teorisë neoklasike të migrimit, sipas së cilës individët priren të zhvendosen drejt zonave që ofrojnë më shumë mundësi ekonomike, edhe kur lëvizin brenda të njëjtit shtet.

Tabela 3: Ndryshimet në shpërndarjen e popullsisë urbane dhe rurale në Kosovë

Viti	2011	2024
Popullsia urbane	661,586	795,627
Popullsia urbane (%)	38.03%	50.18%
Popullsia rurale	1,078,239	789,939
Popullsia rurale (%)	61.97%	49.82%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Një analizë më e detajuar e të dhënave, sipas grupmoshave dhe llojit të vendbanimit për periudhën 2021–2024, tregon një model të qartë të pabarazive demografike rajonale. Siç paraqitet në tabelën më poshtë, në zonat rurale është shënuar një rënie e ndjeshme e popullsisë në të gjitha grupmoshat, veçanërisht tek fëmijët dhe të rinjtë. Për shembull, grupmoshat 0–4 dhe 5–9 vjeç në zonat rurale janë zvogëluar për 44.9% përkatësisht 44.1%, ndërsa adoleshentët dhe të rinjtë e moshës 15–24 vjeç kanë pësuar rënie mbi 30%. Ky trend tregon një largim sistematik të të rinjve nga zonat rurale, të nxitur si nga kërkimi i mundësive më të mira, ashtu edhe nga mungesa e infrastrukturës bazike socio-ekonomike në këto zona. Në anën tjetër, zonat urbane kanë shënuar rritje të dukshme në grupmoshat në moshë pune dhe në ato të moshës së tretë, veçanërisht në intervalin 30–69 vjeç, ku rritjet në disa grupmosha tejkalojnë 90%. Këto ndryshime pasqyrojnë jo vetëm rritjen e numrit të personave në moshë pune që kërkojnë punë dhe shërbime në zonat urbane, por edhe një tendencë të zhvendosjes të moshuarve ose bashkimit familjar brenda këtyre zonave.

⁹ MPB (Ministria e Punëve të Brendshme), Profili i Migracionit 2023, 2024, Prishtina: Ministria e Punëve të Brendshme.

Tabela 4: Popullsia sipas grupmoshës dhe llojit të banimit (në përqindje)

Diferenca (2011-2024)			
Urban		Rural	
0-4	2.1 %	0-4	-44.9 %
5-9	3.9 %	5-9	-44.1 %
10-14	-4.6 %	10-14	-44.7 %
15-19	-7.6 %	15-19	-42.6 %
20-24	8.7 %	20-24	-31.8 %
25-29	6.5 %	25-29	-36.1 %
30-34	14.5 %	30-34	-35.6 %
35-39	15.7 %	35-39	-37.2 %
40-44	26.8 %	40-44	-25.2 %
45-49	36.6 %	45-49	-6.8 %
50-55	39.8 %	50-55	12.5 %
56-59	53.1 %	56-59	27.8 %
60-64	78.5 %	60-64	31.7 %
65-69	92.6 %	65-69	22.5 %
70-74	90.9 %	70-74	13.8 %
75-79	92.7 %	75-79	12.5 %
Totali	20.3 %	Total	-26.7 %

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Ndërmjet viteve 2011 dhe 2024, të dhënat tregojnë se qytetarët e Kosovës kanë lëvizur më shpesh brenda vendit sesa në të kaluarën. Përqindja e atyre që jetojnë ende në të njëjtën komunë dhe në të njëjtin vendbanim është zvogëluar lehtë, ndërsa si zhvendosjet brenda komunës, ashtu edhe ato nga një komunë në tjetrën, janë rritur (tabela 5). Kur këto të dhëna analizohen sipas gjinisë, shfaqet një pabarazi e qartë: gratë dhe vajzat tregojnë nivele dukshëm më të larta të mobilitetit krahasuar me burrat dhe djemtë. Në vitin 2024, më shumë se një e pesta e grave ishin zhvendosur në një komunë tjetër, ndërsa ndër burrat kjo shifër ishte vetëm 9.7 përqind. Edhe brenda së njëjtës komunë, gratë lëvizën më shpesh: 20.9 përqind e tyre kishin ndryshuar vendbanimin brenda komunës, përkundrajt vetëm 10.7 përqind të burrave.


Tabela 5: Modelet e migrimit të brendshëm sipas gjinisë (në përqindje)

Viti	2011			2024		
Indikatori	Komuna dhe vendbanimi janë të njëjta me vendin aktual të vendbanimit të zakonshëm	Komuna e njëjtë me vendin aktual të banimit të zakonshëm, por me një vendbanim të ndryshëm	Komunë e ndryshme nga vendi aktual i banimit të zakonshëm	Komuna dhe vendbanimi janë të njëjta me vendin aktual të vendbanimit të zakonshëm	Komuna e njëjtë me vendin aktual të banimit të zakonshëm, por me një vendbanim të ndryshëm	Komunë e ndryshme nga vendi aktual i banimit të zakonshëm
Kosova	73.3 %	12.6 %	14.2 %	68.1 %	15.8 %	16.1 %
Gratë/ Vajzat e reja	60.4 %	19.1 %	20.5 %	56.4 %	20.9 %	22.7 %
Burra/ Djem të rinj	85.9 %	6.2 %	8.0 %	79.6 %	10.7 %	9.7 %

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Prishtina del bindshëm si komuna me numrin më të madh të të ardhurve, me mbi 60 mijë banorë që sot jetojnë aty vijnë nga komuna të tjera, një tregues i qartë i rolit që ka ky qytet si qendra kryesore ekonomike, administrative dhe arsimore e vendit. Fushë Kosova, edhe pse shumë më e vogël për nga madhësia, ka pjesën më të lartë relative të banorëve të ardhur 56 përqind, duke treguar se komuna mbështetet dukshëm te popullsia që i vjen nga vende të tjera. Edhe Ferizaj e Gjlani kanë përqindje mbi mesataren e të ardhurve, ndërsa Gjakova dhe Prizreni shfaqin lëvizshmëri më të ulët. Kjo mund të nënkuptojë që banorët vendas të Gjakovës dhe Prizrenit qëndrojnë më shumë aty, ose që këto dy komuna nuk tërheqin aq shumë njerëz nga zonat e tjera. Me një mesatare prej 16.1 përqind në nivel vendi, të dhënat tregojnë qartë se lëvizjet brenda Kosovës janë të larta dhe të nxitura kryesisht nga mundësitë për punë, shkollim dhe kushte më të mira banimi. Kjo e bën edhe më të domosdoshme balancimin rajonal dhe një planifikim më të mençur urban për zhvillimin e komunave.

Figura 9: Komunat më të prekura nga migrimi i brendshëm sipas Regjistrimit të Popullsisë 2024



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Këto ndryshime nuk janë të rastësishme, por të rrënjosura në mënyrë strukturore, të shytyra nga nevoja, mundësitë dhe kushtet shoqërore që ndikojnë në vendimet për t'u zhvendosur. Këto prijnë nxjerrin në pah një sfidë të dyfishtë: pakësimin e popullsisë në zonat rurale dhe plakjen e qyteteve, duke e bërë edhe më urgjente nevojën për zhvillim të balancuar rajonal, politika të synuara të strehimit dhe ofrim të shërbimeve të përshtatura sipas nevojave të komuniteteve.

Për t'u përballur me sfidat e ndërlydhura të migrimit ndërkombëtar dhe atij të brendshëm në Kosovë, politikat duhet të synojnë adresimin e pabarazive socio-ekonomike që nxisin lëvizjen e popullsisë, duke menaxhuar njëkohësisht edhe pasojat e demografike të tyre. Në planin ndërkombëtar, ulja e faktorëve shtytës që po i largojnë të rinjtë dhe punëtorët e kualifikuar jashtë vendit, sidomos papunësia e lartë, mungesa e mundësive në karrierë dhe hendeuku i pagave, kërkon programe të synuara të krijimit të vendeve të punës në sektorët me kërkesë të lartë, lidhje më të fortë mes arsimit profesional dhe atë të lartë me nevojat e tregut të punës, si dhe stimuj për kthimin e diasporës, përfshirë lehtësime tatimore dhe grante për nisjen e bizneseve. Njëkohësisht, "brain-drain" në sektorë specifikë si ai i shëndetësisë, i nxitur nga migrimi i mjekëve, infermierëve dhe profesionistëve të tjerë drejt tregjeve më të paguara në BE,

kërkon ndërhyrje urgjente përmes pakove konkurruese të pagave, stimujve të bazuar në performancë dhe mundësive për zhvillim të qëndrueshëm profesional.

Në nivel të brendshëm, politikat duhet të përqendrohen në ngushtimin e hendekut urban-rural përmes investimeve në infrastrukturë rurale, lidhje digjitale, arsim cilësor dhe qasje më të mirë në shëndetësi, si dhe përmes decentralizimit të mundësive ekonomike përmes zonave industriale rajonale dhe mbështetjes për iniciativat lokale të sipërmarrjes. Për të adresuar plakjen e qendrave urbane dhe përqendrimin e popullsisë në Prishtinë dhe në qytetet kryesore, planifikimi urban duhet të fokusohet në banim të përballueshëm, transport publik funksional dhe shërbime që i përshtaten si të rinjve që vijnë për punë, ashtu edhe banorëve të moshuar. Të gjitha këto masa duhet të lidhen me një strategji afatgjatë kombëtare për migrim dhe demografi, e cila ndërthur reformën e tregut të punës, politikat sociale dhe kohezionin territorial, me synim ngadalësimin e largimeve, rigjallërimin e zonave rurale dhe ruajtjen e kapitalit njerëzor të vendit.

VII. Përqendrimi demografik dhe zhvillimi hapësinor

Dendësia e popullsisë është një tregues themelor i zhvillimit demografik dhe hapësinor, që pasqyron mënyrën se si janë të shpërndarë banorët në të gjithë territorin e një vendi. Sipas Regjistrimit të Popullsisë të vitit 2024, dendësia mesatare e popullsisë së Kosovës është 147 banorë për kilometër katror, që përfaqëson një rënie prej rreth 10% krahasuar me vitin 2011, kur ishte 163 banorë për km². Kjo shifër është pothuajse identike me dendësinë e regjistruar në vitin 1981 (145 banorë për km²), duke sinjalizuar se, pas dekadash rritjeje të qëndrueshme të popullsisë, Kosova ka hyrë në një fazë stagnimi demografik ose rënieje modeste. Këto dinamika jo vetëm që po ndryshojnë shpërndarjen gjeografike të popullsisë, por edhe po riformësojnë modelet e përqendrimit demografik, me implikime të rëndësishme për planifikimin urban, zhvillimin e infrastrukturës dhe ofrimin e barabartë të shërbimeve publike në të gjitha rajonet.


Në nivel komunash, dendësia e popullsisë ndryshon ndjeshëm, duke reflektuar si intensitetin e urbanizimit ashtu edhe ndikimin e migrimit të brendshëm. Fushë-Kosova regjistron dendësinë më të lartë në vend, me 779 banorë për kilometër katror, pasuar nga Mamusha me 509 banorë për km² dhe Prishtina me 397 banorë për km². Kjo rritje ilustron ritmin e shpejtë të zgjerimit urban dhe tërheqjen e fortë të zonave të vendosura pranë kryeqytetit, duke ofruar qasje më të mirë në vende pune, shërbime dhe infrastrukturë. Në të kundërt, disa komuna po përjetojnë një rënie të ndjeshme të dendësisë, duke treguar një shpopullim të vazhdueshëm të vendeve rurale. Juniku ka një rënie prej rreth 35 përqind, tani me një mesatare prej vetëm 51.2 banorë për km², ndërsa Ranillugu ka regjistruar një rënie prej 36 përqind, me dendësi të popullsisë që bie në vetëm 32 banorë për km².

Këto modele nxjerrin në pah hendekun demografik në zgjerim midis zonave dinamike urbane dhe komuniteteve rurale në tkurrje, me implikime të rëndësishme për planifikimin hapësinor, ofrimin e shërbimeve dhe zhvillimin e balancuar rajonal. Megjithëse popullsia e përgjithshme e Kosovës ka rënë, numri i njësive të banimit konvencional në nivel kombëtar është rritur me 78 përqind.¹⁰ Në nivel komunal, Fushë-Kosova dallohet me një rritje të jashtëzakonshme prej 310.7 përqind, duke treguar një vrull të jashtëzakonshëm ndërtimi. Kjo rritje përputhet me rritjen e shpejtë të dendësisë së popullsisë dhe rolin e saj si një zonë periferike e Prishtinës, duke tërhequr banorë të rinj përmes mundësive më të përballueshme të banimit dhe afërsisë me kryeqytetin. Komuna të tjera me rritje të dukshme përfshijnë Ferizajin (114%), Lipjanin (83.9%) dhe Gjiilanin (77.9%), ku zgjerimi urban nxitet nga migrimi i brendshëm dhe rritja e kërkesës për pasuri të paluajtshme nga diaspora. Prishtina, pavarësisht se tashmë mban numrin më të madh absolut të njësive të banimit, ka regjistruar gjithashtu një rritje të

¹⁰ UNSTAT e përcakton një banesë konvencionale si një dhomë ose grup dhomash dhe aksesoret e saj në një ndërtesë të përhershme ose në një pjesë të saj të ndarë strukturalisht, e cila, nga mënyra se si është ndërtuar, rindërtuar ose konvertuar, është e destinuar për banim nga një familje dhe nuk përdoret tërësisht për qëllime të tjera.

konsiderueshme prej 96.9 përqind, duke nënvizuar presionin e vazhdueshëm të urbanizimit në kryeqytet.


Figura 10: Përqendrimi demografik dhe zhvillimi hapësinor – njësitë banesore të zakonshme



Burimi: Agjencia Statistikave të Kosovës

Ndërsa numri i njësive të banimit tradicional në Kosovë është rritur ndjeshëm, edhe pjesa e banesave të zbrazëta është rritur, duke arritur në 33 përqind në nivel kombëtar. Në nivel komunal, normat më të larta të banesave të zbrazëta janë regjistruar në Istog (41%), Ferizaj dhe Gjilan (39%), kështu duke treguar për një ofertë të tepërt me banesa në krahasim me nevojat e popullsisë lokale. Në të kundërt, qendrat urbane si Prishtina dhe Prizreni kanë norma relativisht më të ulëta të banesave të lira, duke reflektuar një kërkesë më të fortë dhe më të qëndrueshme për banesa të nxitur nga flukset e popullsisë, mundësitë e punësimit dhe tregjet aktive të qirasë. Megjithatë zgjerimi urban dhe ndërtimi i banesave të reja janë të përqendruara në dhe rreth qendrave kryesore ekonomike, një pjesë e konsiderueshme e këtij fondi të banesave mbetet e pabanuar. Kjo tregon mos efikasitet në planifikimin hapësinor, ku oferta nuk është plotësisht në përputhje me nevojat e banorëve të përhershëm, dhe ndikimin e diasporës, investimet e të cilëve në pasuri të paluajtshme kontribuojnë në shtimin e numrit të banesave të pabanuara.

Figura 11: Përqendrimi demografik dhe zhvillimi hapësinor – njësitë banesore të zbrazëta



Burimi: Agjencia Statistikave të Kosovës

Derisa Kosova përjeton një zhvendosje të shpejtë të popullsisë nga zonat rurale dhe kufitare në qendrat urbane, duke rezultuar në disproporcion të konsiderueshëm hapësinor, zbatimi i politikave efektive për të adresuar këtë trend është bërë i domosdoshëm. Edhe pse qeveria ka disa strategji të ndryshme zhvillimi, ajo duhet të përqendrohet më shumë në zhvillimin e balancuar rajonal që stimulon aktivitetin ekonomik lokal, ofrimin e shërbimeve dhe investimet në infrastrukturë në komunat rurale dhe gjysmë-urbane. Masat mund të përfshijnë stimuj të synuar tatimorë për bizneset që operojnë jashtë qendrave kryesore urbane, zgjerimin dhe përmirësimin e infrastrukturës, investimet në digjitalizim dhe zhvillimin e zonave rajonale inovative. Për më tepër, të dhënat tregojnë se zhvendosja e popullsisë po vjen kryesisht nga zonat e thella kufitare, si Kamenica, Dragashi dhe Juniku, të cilat kanë potencial për zhvillimin e turizmit veror dhe dimëror. Zhvillimi i një strategjie të dedikuar turistike për këto rajone mund të gjeneroj vende pune, të diversifikoj ekonominë lokale dhe të ndihmojë në ngadalësimin e migrimit jashtë vendit.

Për të zbutur sfidat e vrullit të vazhdueshëm të ndërtimit, qeveria, në bashkëpunim të ngushtë me komunat, duhet të zbatojë rregullore më të rrepta të planifikimit urban për të përafruar më

mirë ofertën e banesave me kërkesën aktuale. Menaxhimi i rritjes urbane përmes politikave të koordinuara të transportit dhe banimit është thelbësor për të parandaluar zgjerimin urban dhe për të siguruar që zhvillimet e reja janë të qëndrueshme dhe të integruara. Futja e tatimit progresiv të pronës, veçanërisht në zonat urbane me kërkesë të lartë, si një masë më e gjerë dhe të fortë fiskale mund të ndihmojë në uljen e aktivitetit të tepërt të ndërtimit. Komunat duhet gjithashtu të shqyrtojnë partneritetet publiko-private për të kthyer njësitë e pabanuara ose të paplota në njësi banimi me qira për familjet e reja dhe familjet me të ardhura të ulëta, duke adresuar kështu shqetësimet akute të përballueshmërisë. Në të njëjtën kohë, mbështetja e zhvillimit të ekuilibruar përmes rivitalizimit të komuniteteve rurale nëpërmjet stimujve për familjet e reja, strategjive të qëndrueshme të përdorimit të tokës dhe investimeve të synuara në infrastrukturë, do të ndihmonte në lehtësimin e presionit mbi qendrat urbane, duke rigjallëruar rajonet me popullsi të ulët. Së fundmi, krijimi i një regjistri kombëtar të banesave për të ndjekur sistematikisht tendencat e ofertës, shfrytëzimit dhe ndërtimit do të siguronte bazën e provave të nevojshme për të hartuar politika efektive të strehimit dhe për të siguruar që zhvillimi i ardhshëm të jetë në përputhje me realitetet demografike dhe prioritetet rajonale.

VIII. Shënimet përmbyllëse dhe rekomandimet e politikave

Regjistrimi i Popullsisë 2024 i Kosovës ofron një pasqyrë thelbësore për të shqyrtuar transformimet demografike, sociale dhe ekonomike në vend. Trendet në zhvillim, si plakja e popullsisë, ndryshimet në modelet të migrimit, urbanizimi dhe zhvillimi i pabarabartë rajonal, tashmë po ushtrojnë presion mbi shërbimet publike, tregun e punës dhe infrastrukturën. Duke marrë parasysh këto ndryshime demografike, është thelbësore që përgjigjet e politikave të ndërtohen mbi konceptin e reziliencës demografike, kapacitetin e shoqërive për të parashikuar, kuptuar dhe përshtatur ndaj dinamikave të popullsisë. Rezilienca demografike i mundëson Kosovës jo vetëm të zbusë efektet negative të trendëve si plakja e popullsisë, fertiliteti i ulët, emigrimi dhe zbrazja e zonave rurale, por edhe të shfrytëzojë mundësitë që ato sjellin. Shoqëritë e qëndrueshme e kuptojnë se ndryshimet demografike janë të ndikuara nga ndërveprimi kompleks i faktorëve socialë, kulturorë, ekonomikë, mjedisorë dhe politikë. Adresimi i këtyre sfidave kërkon politika gjithëpërfshirëse, të bazuara në evidencë dhe të orientuara drejt njerëzve, të cilat mbrojnë të drejtat dhe zgjerojnë mundësitë. Kjo përfshin investime në arsim, shëndetësi, mbrojtje sociale, zhvillim ekonomik dhe qeverisje, duke siguruar që politikat të reflektojnë realitetet dhe aspiratat e komuniteteve të ndryshme. Mbi të gjitha, rezilienca demografike është si proaktive duke parashikuar dhe planifikuar ndryshimet ashtu edhe transformuese duke sfiduar normat dhe strukturat tradicionale që pengojnë progresin. Një qasje e tillë është themel i zhvillimit të qëndrueshëm dhe politikëbërjes efektive në Kosovë.

Ky dokument nxjerr në pah gjetjet kryesore në pesë fusha strategjike: strukturën moshore, arsimin, shëndetësinë, migrimin dhe zhvillimin hapësinor. Po ashtu, përshkruan një sere rekomandimesh prioritare për qeverinë që synojnë nxitjen e qëndrueshmërisë demografike dhe socioekonomike afatgjatë, duke siguruar njëkohësisht rritje gjithëpërfshirëse dhe të barabartë.

Gjetjet kryesore nga të dhënat e Regjistrimit 2024

- Kosova po përjeton një zhvendosje demografike graduale, por të dukshme drejt një popullsie më të moshuar e cila sjell sfida të rëndësishme makroekonomike. Procesi i plakjes pritet të rezultojë në një forcë pune të reduktuar, konsum dhe investime më të ulëta, dhe presione fiskale në rritje mbi sistemin e pensioneve dhe shërbimet sociale dhe shëndetësore.
- Trendet kontraktuese të shpopullimit rural dhe zgjerimit urban kanë krijuar një çekuilibër gjeografik në infrastrukturën arsimore. Ndërsa zonat rurale përballen me nënshfrytëzimin e shkollave, komunat urbane me tej ngarkim të kapaciteteve.

- Rishpërndarja e popullsisë e evidentuar në Regjistrimin e Popullsisë të vitit 2024 ofron një mundësi për rishikimin e burimeve në shëndetësi. Qendrat urbane me rritje të popullsisë kërkojnë investime shtesë, ndërsa zonat me popullsi në rënie mund të kenë nevojë për shërbime të reduktuara, por që janë thelbësore.
- Migrimi, si i brendshëm ashtu edhe i jashtëm mbeten një nga sfidat më urgjente demografike për Kosovën. Largimi i të rinjve, përqendrimi i popullsisë në zonat urbane, ka thelluar pabarazitë rajonale dhe ka dobësuar bazën ekonomike në zonat rurale.
- Regjistrimi i popullsisë nxjerr në pah ndryshime dramatike në strukturën hapësinore të Kosovës, dendësimin urban, rënien rurale të popullsisë dhe një numër në rritje të shtëpive të pabanuara. Këto ndryshime kërkojnë një qasje të integruar ndaj planifikimit që balancon rritjen, rigjallërimin dhe qëndrueshmërinë.

Rekomandimet e politikave

- Promovimi i pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore. Duke pasur parasysh që gratë përfaqësojnë më shumë se dy të tretat e popullsisë në moshë pune, masat e synuara, të tilla si zgjerimi i qasjes në kujdesin ndaj fëmijëve, banimin e përbalueshëm, dhe sigurimi i lejes së paguar të lindjes, pushim prindëror, mund të zhbllokojnë potencial të konsiderueshëm të pashfrytëzuar të punës dhe të ndihmojnë në zbutjen e efekteve të plakjes së popullsisë. Përveç kësaj, politikat që inkurajojnë punën fleksibile mbështesin mundësitë e punës në distancë dhe nxisin sipërmarrjen e grave mund të forcojnë më tej pjesëmarrjen dhe qëndrueshmërinë ekonomike.
- Të fillojë një dialog publik mbi reformën gjithëpërfshirëse të pensioneve për të siguruar qëndrueshmëri afatgjatë. Si hap i parë, të përputhet mosha e daljes në pension me jetëgjatësinë – të zbatohet një mekanizëm që rishikon dhe përshtat moshën statutores të daljes në pension në përputhje me jetëgjatësinë, siç rekomandohet nga FMN-ja.
- Të miratohet një qasje e kujdesit afatgjatë me komunitetin në radhë të parë që i jep përparësi shërbimeve në shtëpi dhe atyre në komunitet mbi kujdesin institucional, duke mbështetur qëndrueshmërinë dhe duke u përshtatur me preferencat sociale. Kjo përfshin ofrimin e ndihmave modeste, trajnimit dhe shërbimeve të përkohshme për kujdestarët informalë për të zvogëluar barrën familjare dhe për të vonuar institucionalizimin, ndërsa njëkohësisht zgjerohet fuqia punëtore e kujdesit përmes programeve të përmirësuar të trajnimit të infermierisë që integrojnë kompetencat e kujdesit afatgjatë në kurrikulat mjekësore dhe profesionale.
- Të forcohen politikat e popullsisë bazuar në forcimin e mirëqenies familjare, barazisë gjinore dhe ekuilibrit punë –jetë, të arritura përmes një sistemi bujar dhe fleksibël të lejes

- prindërore dhe kujdesit të përballueshëm dhe me cilësi të lartë për fëmijët, të modeluar sipas shembujve të suksesshëm ndërkombëtarë, të tilla si leja e patransferueshme e babait, përfitimet e nënës, ndihmat financiare për fëmijët, përjashtimet nga taksat mbi të ardhurat, etj.
- Të përshpejtohen investimet në shkolla, klasa të reja dhe staf të kualifikuar në komunat me rritje të shpejtë. Zvogëlimi i madhësisë së klasave dhe modernizimi i ambienteve duhet të jenë përparësi për të ruajtur cilësinë dhe barazinë arsimore. Njëkohësisht, rekrutimi dhe trajnimi i mësuesve të kualifikuar është thelbësor për të zvogëluar madhësinë e klasave dhe për të ruajtur cilësi të lartë mësimore. Plotësimi i këtyre përpjekjeve me zgjidhje dixhitale dhe fleksibile të të nxënit do të ndihmojë në menaxhimin efektiv të popullatës në rritje të studentëve, duke siguruar njëkohësisht akses në një arsim modern dhe me cilësi të lartë.
- Për të adresuar çekuilibrat demografikë, politikat arsimore duhet të koordinohen ngushtë me iniciativat e zhvillimit ekonomik, duke u përqendruar në nxitjen e rritjes së biznesit lokal dhe krijimin e vendeve të punës në komunat rurale në depopullim për të mbajtur familjet e reja dhe për të stabilizuar regjistrimin në shkollë. Përveç kësaj, nxitja e partneriteteve publiko-private mund të mbështesë zhvillimin e programeve lokale arsimore dhe profesionale që përputhen me nevojat ekonomike rajonale, duke siguruar që arsimi kontribuon drejtpërdrejt në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit.
- Qeveria duhet të miratojë një qasje të bazuar në të dhëna për planifikimin e arsimit duke monitoruar vazhdimisht trendet demografike dhe regjistrimin në shkollë, duke përdorur këtë informacion për të udhëhequr investimet në infrastrukturë dhe vendimet për personelin. Modelet e planifikimit dinamik duhet të zhvillohen për të lejuar përshtatje të shpejta në kapacitetin e shkollave në përgjigje të ndryshimeve të popullsisë, duke integruar treguesit demografikë dhe ekonomikë në strategjitë afatgjata për të siguruar që sistemi arsimor të mbetet efikas, i barabartë dhe i qëndrueshëm.
- Promovimi të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe zhvillimi i "ekonomisë së argjendte" për të nxitur shoqëri gjithëpërfshirëse ku individë të të gjitha moshave mund të marrin pjesë aktive, të kontribuojnë dhe të përfitojnë nga jetëgjatësia e rritur, duke maksimizuar kështu mundësitë sociale dhe ekonomike të një popullsie në plakje.
- Të përshtaten buxhetet e shëndetësisë komunale sipas shifrave aktuale të popullsisë për të siguruar ofrimin e barabartë të shërbimeve dhe për të ruajtur aksesin bazë në kujdesin shëndetësor në zonat e shpopulluara përmes klinikave mobile, të futet shëndetësia elektronike dhe të forcohet përdorimi i telemjekësisë. Njëkohësisht, të zgjerohen objektet dhe stafi në qendrat urbane në rritje. Përveç kësaj, të përmirësohet dhe forcohet vizita në shtëpi për pacientët kronikë dhe të ofrohet kujdes paliativ. Për të siguruar ofrimin efikas dhe të vazhdueshëm të shërbimeve shëndetësore, qeveria duhet gjithashtu të promovojë rishpërndarjen fleksibile të personelit shëndetësor në zonat që

- përjetojnë kërkesë në rritje dhe të mbështesë bashkëpunimin ndërkomunal përmes shërbimeve të përbashkëta, siç janë rrjetet rajonale të kujdesit parësor ose sistemet e përbashkëta të prokurimit, duke u mundësuar komunave të ruajnë mbulimin në mënyrë efektive, duke optimizuar përdorimin e burimeve.
- Për të siguruar vazhdimësinë e shërbimit shëndetësor në komunat që përjetojnë rënie të ndjeshme të popullsisë (mbi 30–40 përqind), duhet të inkorporohen mekanizma të përkohshëm stabilizimi, duke përfshirë financim shtesë të synuar në varësi të zhvillimit të një plani për vazhdimësinë e shërbimit. Përshtatjet e financimit duhet të zbuten duke përdorur masa të përziera të popullsisë, duke kombinuar regjistrat administrativë me të dhënat e regjistrimit për të zbutur luhatjet e papritura në ndarjet për kokë banori.
- Me një popullsi në plakje, Kosova duhet të investojë më shumë në shërbimet e kujdesit afatgjatë, të promovojë plakjen aktive të shëndetshme, kujdesin parandalues duke përfshirë programet e shqyrtimit dhe menaxhimit të sëmundjeve kronike.
- Për të parandaluar migrimin – si të brendshëm ashtu edhe jashtëm – të stimulojë zhvillimin ekonomik në zonat më pak të populluara përmes investimeve të synuara në bujqësi, industri të vogël dhe turizëm rural.
- Për të zbutur ikjen e trurit në sektorë kritikë si shëndetësia, qeveria duhet të rrisë mbajtjen e profesionistëve të kualifikuar duke ofruar paga konkurruese dhe stimuj të bazuar në performancë. Strategjitë e synuara të mbajtjes duhet të zhvillohen për sektorë të tjerë kyç që përjetojnë dalje të konsiderueshme të fuqisë punëtore të kualifikuar.
- Investoni në të rinj dhe aftësi për të zvogëluar emigrimin dhe për të stimuluar rritjen ekonomike duke përmirësuar arsimin, trajnimin profesional dhe mundësitë e punësimit për të rinjtë. Sektori në rritje i TIK–ut në Kosovë mund të jetë tërheqës për kthimin nga migrimi dhe talentet e rinjë.
- Përfshirja e të rinjve në vendimmarrje dhe zhvillimin e politikave për të siguruar që perspektivat, nevojat dhe idetë e tyre inovative të ndihmojnë në formësimin e politikave më gjithëpërfshirëse dhe të fokusuara në të ardhmen.
- Zhvillimi i politikave dhe programeve për të tërhequr të kthyerit dhe për të shfrytëzuar kapitalin, njohuritë dhe rrjetet e diasporës për të rigjallëruar ekonominë lokale. Për më tepër, qeveria duhet të monitorojë vazhdimisht trendet demografike dhe flukset e migrimit për të mbështetur vendime politike proaktive dhe të bazuara në prova.
- Menaxhimi i rritjes urbane përmes politikave të transportit dhe strehimit për të parandaluar zgjerimin e parregulluar dhe për të siguruar aksesin në shërbime në qytetet me rritje të shpejtë.

- Për të forcuar planifikimin urban dhe menaxhimin e strehimit, qeveria duhet të zbatojë rregullore më të rrepta për të siguruar që furnizimi i strehimit të jetë në përputhje me kërkesën aktuale dhe të parandalojë shtrirjen e paplanifikuar urbane. Zbatimi i taksave progresive të pronës në zonat me kërkesë të lartë mund të ndihmojë në moderimin e aktivitetit të tepërt të ndërtimit, ndërsa promovimi i partneriteteve publik–privat për të kthyer banesat e paplota ose të pabanuara në njësi qiraje të përballueshme do të mbështesë familjet e reja dhe familjet me të ardhura të ulëta, duke adresuar sfidat si të disponueshmërisë së banesave ashtu edhe të përballueshmërisë.
- Mbështetja e zhvillimit të ekuilibruar përmes promovimit të rigjenerimit të komuniteteve rurale përmes stimujve për familjet e reja, përdorimit të qëndrueshëm të tokës dhe investimeve të synuara në infrastrukturë.
- Koordinoni përdorimin e tokës dhe planifikimin e infrastrukturës duke integruar të dhënat e popullsisë në kornizat e zhvillimit hapësinor për të udhëhequr investimet në strehim, shkolla, kujdes shëndetësor dhe shërbime publike.